



**INFLACIONI:
ÇFARË DUHET TË DIMË PËR TË?**



PËRMBAJTJA

<i>INFLACIONI: ÇFARË DUHET TË DIMË PËR TË?</i>	<i>4</i>
<i>INFLACIONI: SI MATET AI?</i>	<i>5</i>
<i>INFLACIONI: SA LLOJE DO TË MUND TË INDENTIFIKONIM?</i>	<i>10</i>
<i>INFLACIONI: A ËSHTË AI NJË FENOMEN MONETAR?</i>	<i>20</i>
<i>INFLACIONI: SI SHKAKTOHET AI?</i>	<i>22</i>
<i>INFLACIONI: KUSH PËRGJIGJET PËR TË?</i>	<i>27</i>
<i>INFLACIONI: ÇFARË PASOJASH MBART AI?</i>	<i>34</i>



INFLACIONI: ÇFARË DUHET TË DIMË PËR TË?

Nuk është nevoja të jesh një studiues i teorisë ekonomike për të kuptuar se çfarë është inflacioni dhe për më tepër se çfarë është i aftë të shkaktojë ai. Po kështu, është e vërtetë se edhe shkaqet që e prodhojnë atë njihen përgjithësisht. Ajo çka kuptohet rëndom ka të bëjë me faktin se atje ku ka shumë para ka rritje çmimesh; se atje ku të mirat materiale dhe shërbimet e ofruara janë të pakta, përsëri do të ballafaqohemi me rritje çmimesh, rritje, e cila në fund të fundit, për të dyja rastet e cituara do të thotë që ka inflacion.

Shpjegimet e mësipërme përbëjnë edhe thelbin e shpjegimit të inflacionit në teorianë ekonomike. Inflacion që shkaktohet nga rritja e pakontrolluar e kërkesës agregate dhe inflacion që shkaktohet nga faktorët *shock* në ofertën agregate. Në praktikë gjërat nuk janë kaq të thjeshta. Bie fjala, si do ta masim inflacionin dhe kujt duhet “t’ia faturojmë” atë? Si shpjegohet që ekonomi me të njëjtat përmasa – ajo amerikane dhe ajo ruse, për shembull – kanë shkallë të

ndryshme imunizimi ndaj inflacionit? Pse thuhet që në ekonomitë e brishta shpesh herë inflacioni është pjesë e “mëkateve” të politikanëve?

Pyetjet e kësaj natyre mund të jenë të shumta, ashtu sikurse dhe përgjigjet e një pjese të tyre, në tekstet teorike, trajtohen nga këndvështrime të ndryshme. Megjithatë, me kalimin e viteve, sidomos gjatë dekadës së fundit, mendimet dhe konkluzionet për të shmangur përvojat inflacioniste po konvergojnë gjithnjë e më shumë. Ky unison, para së gjithash, konsiston në angazhimin e drejtpërdrejtë të autoriteteve, jo vetëm për të luftuar inflacionin, por edhe për të treguar rrugët dhe mundësitë konkrete që ekzistojnë për të arritur këtë qëllim.

Duke vazhduar në këtë linjë do të theksonim edhe shumë gjëra të tjera, të cilat pa pretenduar se do të trajtohen në gjithë përmbajtjen e tyre, natyrshëm do të jenë pjesë e kësaj broshure. Për të krijuar hapësirat e nevojshme për

trajtimin e problemeve në një mënyrë më teknike do të ishte mirë që në “stacionin” e parë të hidhnim vështrimin për një moment mbi përkufizimin dhe teorinë më të spikatura mbi inflacionin.

INFLACIONI: SI MATET AI?

Inflacioni nga një këndvështrim i përgjithshëm është thjesht një “superprodhim” i parasë, i cili në njërin anë, në mënyrë të dukshme rrit çmimet e mallrave dhe në anën tjetër ul fuqinë blerëse të parasë. Në një gjuhë më të thjeshtë do të thonim se inflacioni ndodh atëhere kur niveli i përgjithshëm i çmimeve dhe i kostove në ekonomi rritet, domethënë kur rritet çmimi i bukës, i naftës, i veturave etj., ose kur rritet niveli i pagave, çmimi i tokës etj.. Është normale që rritja e çmimeve të mos jetë në të njëjtin nivel në të gjithë mallrat e përmendur më sipër dhe po ashtu dhe koha në të cilën regjistrohet rritje çmimesh të mos jetë e njëjtë për dy mallra të ndryshëm. Në këtë kuptim, si periudha inflacioniste do të përkufizojmë ato periudha kohe kur niveli i çmimeve të konsumit – i matur nga ndryshimi i një

indeksi të çmimeve të konsumit – rritet në përgjithësi. Kështu, sa herë që në gazeta apo në media, njoftohet se “inflacioni ka rënë” apo “pritjet inflacioniste në ekonomi janë rritur”, shkruarit kanë parasysh lëvizjet në një indeks çmimesh, i cili në pjesën më të madhe të vendeve njihet si indeksi i çmimeve të konsumit ose shkurt IÇK (në anglisht CPI – consumer price index).

IÇK nuk është gjë tjetër veçse një matje e çmimeve të një shporte mallrash konsumi dhe shërbimesh. Zakonisht ndër grupet më të mëdha që përfshihen në një shportë të IÇK-së janë artikujt ushqimorë, veshjet, blerja dhe mirëmbajtja e shtëpive, karburantet, transporti dhe kujdesi mjekësor. Deri në këtë moment duket se gjërat janë të thjeshta, por çështja fillon të vështirësohet kur përcaktohet pesha që secili nga këto grupe do të zërë ndaj totalit. E thënë më qartë, duhet vendosur se sa do të rritet niveli i përgjithshëm i çmimeve në qoftë se çmimet e grupit ushqimor do të rriten me 10 për qind. Në praktikë përcaktimi i peshave bazohet në rëndësinë ekonomike që ka çdo grup, rëndësi e cila matet nga ajo pjesë e shpenzimeve – ndaj totalit –



që konsumatorët harxhojnë për atë grup mallrash. Më konkretisht, në qoftë se konsumatorët iu kushtojnë vetëm 15 për qind të buxhetit të tyre shpenzimeve të veshmbathjes, atëhere pesha që ky grup do të zërë në shportë do të jetë 15 për qind.


Siç vihet re, janë konsumatorët ata, që me mënyrën se si shpenzojnë, përcaktojnë dhe “fytyrën” e inflacionit. Është për këtë

arsye që indekset në vende të ndryshme kanë pika të përbashkëta, të cilat më së shumti kanë të bëjnë me praninë e të njëjtave grupe mallrash si dhe me përngjasinë e peshave që këto grupe zënë ndaj totalit. Këto ngjashmëri bëhen më të dukshme nëse krahasohen ekonomi me struktura dhe me shkallë zhvillimi të ngjashme, siç janë për shembull ekonomia franceze dhe ajo gjermane.

SHTOJCË 1. IÇK NË SHQIPËRI.

Ekzistenca e inflacionit në Shqipëri për herë të parë u deklarua në vitin 1990, kur u pranua publikisht se ekonomia shqiptare kishte kohë që po gërryhej nga inflacioni i fshehur i akumuluar ndër vite. Zyrtarisht inflacioni filloi të matej që nga korriku i vitit 1992. Në vendin tonë, për matjen e inflacionit përdoret indeksi i çmimeve të konsumit. Gjatë gjithë dekadës së kaluar shporta e mallrave – 215 artikuj gjithsej të ndarë në tetë grupe kryesore: “ushqim, pije dhe duhan”, “veshje dhe këpucë”, “qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji”, “artikuj shtëpiakë dhe mirëmbajtje”, “kujdes mjekësor”, “transport dhe telekomunikacion”, “argëtim, arsim dhe kulturë” dhe “kujdes personal” – bazohet në vrojtimin e kryer nga INSTAT në vitin 1993. Të dhënat e atij vrojtimi paraqisnin sjelljen e konsumatorit shqiptar në fillim të viteve 1990, dhe për rrjedhim, grupi i parë, ai ushqimor, zinte dhe 72.3 për qind të totalit të shportës. Kjo përqindje e lartë ka bërë që inflacioni të ishte i dominuar nga zhvillimet e këtij grupi. Në shumicën e rasteve, sidomos në periudha të karakterizuara nga një stabilitet i përgjithshëm, inflacioni është ndikuar nga ndryshimet që kanë pësuar çmimet e nëngrupeve ushqimore të tilla si “fruta dhe perime”, “bulmet dhe vezë”, “mish dhe peshk” etj.

Figurë 1. Ndryshimi 12 - mujor i IÇK.



Duke u marrë ende me artikujt e detajuar të grupit ushqimor do të theksonim se, në mënyrë të veçantë, roli i nëngrupit “fruta dhe perime” ka qenë i një rëndësie të madhe për vetë ecurinë e IÇK dhe meqenëse çmimet e këtij nëngrupi kanë njohur luhatje të madhe kjo gjë është pasqyruar edhe në ecurinë e IÇK.


Figura 1, pasqyron se si ka qenë inflacioni 12-mujor në periudhën dhjetor 1998 – dhjetor 2000 dhe si do të ishte ai në qoftë se nuk do të merrnim në konsideratë zhvillimet në nëngrupin ushqimor “fruta dhe perime”. Grafiku nxjerr në pah një fakt shumë domethënës: atë që, në qoftë se përjashtojmë grupin “fruta dhe perime”, inflacioni në Shqipëri, gjatë vitit 2000 ka qenë shumë pranë nivelit zero. Dikush mund të mendojë se gjërat qenkan fare të thjeshta. Mjafton të neglizhojmë praninë e këtij nëngrupi ushqimor dhe... Eureka! Inflacioni bëhet zero! Më entuziastët mund të thonë: si mund të jetë inflacioni në Shqipëri pasqyrim i rritjes së çmimeve në artikuj të tillë ushqimorë si domate, lakra, rrush, presh, fasule etj.?

Por realiteti është ndryshe. Shpenzimet e familjeve shqiptare për këtë zë janë të larta dhe për rrjedhim nuk mund të injorohen. Pesha e lartë e këtij grupi ndoshta shpjegohet me nivelin e ulët të të ardhurave mesatare mujore të familjes shqiptare. Nëse sasia e harxhuar e frutave dhe e perimeve gjatë një muaji, e shprehur në terma mesatarë, është e barabartë – sigurisht që është më e vogël – si për një familje shqiptare ashtu dhe për një familje britanike, për shembull 30 mijë lekë, po t’i vinim ato në raport me buxhetin që secila nga dy familjet ka në dispozicion, diferencat do të ishin të dukshme.

Në rastin e familjes shqiptare, në qoftë se do të supozonim se të ardhurat mujore në dispozicion të familjes janë 100 mijë lekë, do të kishim një koeficient në masën 30 për qind : $30.000/100.000=30$ për qind. Ndërkohë, në rastin e familjes britanike po të supozonim një buxhet të disponueshëm në masën 1 milion lekë, pesha e këtij grupi do të ishte vetëm 3 për qind dhe fakti që ky zë është i ndikuar nga stina dhe nga plot faktorë të tjerë nuk do të ketë rëndësi.

Shembulli i mësipërm është thjesht imagjinar, por megjithatë një gjë është e saktë, se ndërsa diferencat në pjesën që shpenzohet për fruta dhe perime nga ana e të dyja familjeve mund të jenë të pranishme por që gjithësesi në nivele të ulëta, diferencat midis asaj se çfarë kanë këto familje në dispozicion për të harxhuar janë të mëdha, duke përbërë dhe shkakun kryesor të ndryshimeve në përqindjen që zënë mallrat ushqimorë në totalin e shpenzimeve familjare.

Figurë 2. Shporta e re e IÇK.



Megjithatë, kompozimi i vjetër i shportës tashmë i takon së kaluarës. Anketimi i buxhetit të familjes në periudhën dhjetor 1999 – nëntor 2000, krijoi mundësinë e ndërtimit të një shporte të re, e cila përveç një shpërndarjeje më realiste të peshave të grupeve, përmban edhe më shumë artikuj, plot 262 copë. Indeksi përfshin mallra dhe shërbime në kategoritë e mëposhtme: ushqime dhe pije joalkolike; pije alkolike dhe duhan; veshje dhe këpucë; qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji; mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje shtëpie; shëndetësi; transport; komunikim; argëtim dhe kulturë; shërbim arsimor; hotele, kafene dhe restorant; mallra dhe shërbime të ndryshme.

INFLACIONI: SA LLOJE DO TË MUND TË IDENTIFIKONIM?

Në realitetin e përditshëm na bie rasti të dëgjojmë njoftime të lidhura me tregues të ekonomisë, tek të cilët pa dyshim bën pjesë dhe inflacioni. Ajo që duhet të na bëjë përshtypje në shikim të parë është shifra e publikuar; është e lartë apo e ulët; është në nivel vjetor apo mujor etj..

Është një e vërtetë e madhe që ka shoqëruar dhe do të shoqërojë

zhvillimin e historisë njerëzore: çmimet e mallrave dhe të konsumit tentojnë gjithnjë të rriten dhe çështja qëndron në atë se sa do të jetë kjo rritje dhe për më tepër se sa e aftë është një ekonomi të mbajë rritjen e çmimeve të konsumit në hapin që ajo dëshiron. Për të dhënë në mënyrë të përmbledhur këtë dukuri mund të përmendim thënien e Jimmy W. Marsh: “inflacioni mund të izolohet (ndalet) siç pretendojnë ekonomistët, por sa herë që ne shkojmë për të psonisur, duket se ai është liruar me kusht para kohe”.

SHTOJCË 2. PAK INFORMACION SHITESË PËR TA KUPTUAR MË MIRË ATË.

Perceptimi i llojeve të inflacionit do të ishte më i lehtë në qoftë se do të kishim një kuptim më të mirë rreth disa matësve statistikorë që kanë të bëjnë me periodicitetin, me periudhën e raportimit, me vlerat minimale, maksimale, me sezonalitetin, me tendencën, me mesataren etj..

Duke u ndalur fillimisht tek periodiciteti duhet thënë se është detyrim institucional i Institutit të Statistikave, INSTAT-it të publikojë jo më vonë se data 8 e muajit pasardhës, shifrën e inflacionit për muajin që kemi lënë pas para tetë ditëve (muaji raportues). Informacioni pasqyron nivelin e ri të indeksit të çmimeve të konsumit në fund të muajit raportues si në total ashtu dhe në nivelet e indekseve të tetë grupeve kryesore. Për rëndësinë që ka grupi “ushqim, pije dhe duhan”, informacioni për këtë grup jepet jo vetëm në total, por edhe për secilin nga nëngrupet e tij. Tabela në vijim pasqyron informacionin bazë që bëhet publik çdo muaj nga ana e INSTAT-it.

Tabela 1. Indeksi i çmimeve të konsumit.
Dhjetor '93 = 100

	Pesha	Dhje-00	Jan-01	Shku-01	Mar-01	Pri-01	Maj-01	Qer-01	Kor-01	Gush-01
Totali	1.000	229.6	226.6	223.5	224.2	226.1	226.5	225.0	222.3	220.1
Ushqim, pije dhe duhan	0.724	218.1	214.4	211.2	212.2	215.1	215.8	213.5	209.9	206.4
Bukë dhe drithëra	0.155	212.8	212.7	212.3	217.0	216.9	216.8	217.8	219.7	219.7
Mish, pulë dhe peshk	0.133	214.3	212.7	211.4	212.7	212.7	213.6	212.8	213.7	214.5
Bulmet dhe vezë	0.130	180.2	176.8	169.7	167.8	165.4	167.4	164.8	163.9	163.2
Vaj dhe yndyrma	0.072	183.4	182.7	179.6	177.6	177.0	179.3	177.9	177.0	177.4
Fruta dhe perime	0.150	300.0	288.0	282.0	283.9	300.4	300.6	291.7	272.8	255.2
Sheqer, kafë dhe çaj	0.040	179.2	176.9	175.8	174.4	173.5	172.5	173.3	173.4	168.5
Pije	0.020	160.4	158.9	160.3	159.8	160.1	160.3	160.4	160.4	162.4
Ushqim dhe pije jashtë shtëpisë	0.009	223.3	223.5	224.4	224.4	226.5	223.1	223.1	223.6	224.4
Duhan	0.017	165.5	165.8	164.1	162.9	162.9	163.8	163.8	163.1	163.1
Veshje dhe këpucë	0.028	199.9	199.1	196.0	194.4	193.6	192.9	192.0	191.3	189.4
Qira, ujë, karburant dhe energji	0.064	525.9	523.1	514.0	515.4	514.6	514.3	516.5	516.4	522.4
Mallra shtëpiake	0.083	136.1	135.8	135.8	134.6	134.3	135.0	134.7	134.4	134.1
Kujdes mjeksor	0.009	326.4	327.2	326.8	328.4	328.4	328.4	328.2	329.1	329.5
Transport dhe telekomunikacion	0.052	238.6	237.2	236.2	236.2	236.0	234.9	237.0	236.2	235.4
Rikrijim, edukim dhe kulturë	0.036	137.0	136.5	136.0	134.9	132.9	132.6	132.3	132.0	132.6
Kujdes personal	0.005	192.4	192.6	192.0	191.4	190.6	190.8	191.3	191.4	192.1

Informacioni në formën e paraqitur më sipër është i mjaftueshëm për të filluar përpunimet e mëtejshme, të cilat do të na ndihmojnë në analizën e inflacionit. Siç e kemi theksuar më sipër inflacioni, i cili haset edhe me termin 'norma e inflacionit', është thjesht ndryshimi relativ në përqindje i nivelit të IÇK, të verifikuar në muajin raportues, nga niveli i verifikuar në një periudhë të mëparshme. Në qoftë se do të shënonim muajin raportues me t dhe periudhën e mëparshme me t-1, atëhere inflacioni p do të ishte:

$$P_t = [(I_t - I_{t-1}) / I_{t-1}] * 100$$

ku: I qëndron për vetë IÇK dhe ku i merr vlerën nga 1 në 12. Duke iu referuar tabelës së mësipërme, në rast se t do të jetë muaji gusht 2001, atëhere muaji korrik 2001 është t-1 dhe aplikimi i formulës së mësipërme për llogaritjen e ndryshimit të çmimeve nga muajit-1 në muajin t, nuk është gjë tjetër veçse llogaritja e normës mujore të inflacionit, matur si një ndryshim relativ i IÇK në muajin raportues (gusht 2001) me atë të muajit korrik 2001.

Në qoftë se do të supozonim se t-1, t-2, t-3, ..., t-12, qëndrojnë përkatësisht për muajt korrik 2001, qershor 2001, maj 2001, ..., gusht 2000, atëhere kuptohet që në rastin e periudhës t-3 përftohet norma tremujore e inflacionit dhe në rastin e periudhës t-12 përftohet norma vjetore e inflacionit. Tabela 2, pasqyron normën mujore të inflacionit në Shqipëri mbështetur në informacionin e dhënë nga tabela 1.

Tabela 2. Norma mujore e inflacionit në përqindje.

Dhjetor '93 = 100	Dhje-00	Jan-01	Shku-01	Mar-01	Pri-01	Maj-01	Qer-01	Kor-01	Gush-01
Totali	4.6	-1.3	-1.3	0.3	0.8	0.2	-0.7	-1.2	-1.0
Ushqim, pije dhe duhan	6.6	-1.7	-1.5	0.5	1.4	0.3	-1.1	-1.7	-1.7
Bukë dhe drithëra	0.0	0.0	-0.2	2.2	-0.1	-0.1	0.5	0.9	0.0
Mish, pulë dhe peshk	0.6	-0.8	-0.6	0.6	0.0	0.4	-0.4	0.4	0.4
Bulmet dhe vezë	2.2	-1.9	-4.0	-1.1	-1.5	1.2	-1.5	-0.6	-0.4
Vaj dhe yndyrna	0.5	-0.4	-1.7	-1.1	-0.4	1.3	-0.8	-0.5	0.2
Fruta dhe perime	24.8	-4.0	-2.1	0.7	5.8	0.0	-3.0	-6.5	-6.5
Sheqer, kafë dhe çaj	0.4	-1.3	-0.6	-0.8	-0.5	-0.6	0.5	0.0	-2.8
Pije	1.4	-0.9	0.9	-0.3	0.2	0.1	0.0	0.0	1.3
Ushqim dhe pije jashtë shtëpisë	0.4	0.1	0.4	0.0	0.9	-1.5	0.0	0.2	0.3
Duhan	-0.2	0.2	-1.0	-0.8	0.0	0.6	0.0	-0.5	0.0
Veshje dhe këpuçë	0.0	-0.4	-1.5	-0.8	-0.4	-0.4	-0.5	-0.3	-1.0
Qira, ujë, karburant dhe energji	0.8	-0.5	-1.7	0.3	-0.1	-0.1	0.4	0.0	1.1
Mallra shtëpiake	0.3	-0.2	0.0	-0.9	-0.2	0.6	-0.2	-0.3	-0.2
Kujdes mjekësor	1.4	0.3	-0.1	0.5	0.0	0.0	-0.1	0.3	0.1
Transport dhe telekomunikacion	-0.2	-0.6	-0.4	0.0	-0.1	-0.5	0.9	-0.3	-0.3
Rikrijim, edukim dhe kulturë	0.2	-0.4	-0.3	-0.8	-1.5	-0.2	-0.2	-0.2	0.4
Kujdes personal	0.0	0.1	-0.3	-0.3	-0.4	0.1	0.2	0.1	0.3

Cila është rëndësia e matjeve kaq të ndryshme kur i referohemi normës së inflacionit? Pse shpesh herë thuhet: inflacioni në muajin maj u rrit me 1 për qind; ndërkohë që në raste të tjera po nga goja e autoriteteve thuhet se në muajin maj inflacioni me bazë vjetore shënoi 4 për qind. Dikush tjetër mund të jetë i interesuar nëse ka kuptim shprehja e inflacionit në terma mesatarë etj.. Imagjinoni një vend x ku shpallet se norma mujore e inflacionit p_m gjatë muajit raportues m_1 (ku i merr vlerat nga 0 deri 12) ka qenë 2 për qind dhe një vend tjetër y, ku norma vjetore p_v e shpallur e inflacionit për të njëjtën periudhë raportuese është 2 për qind. Në vështrim të parë krijon bindjen se vendi x vuan nga inflacioni ndërkohë që vendi y paraqet një ekonomi të stabilizuar me inflacion në vlera të ulëta. Me një llogari të thjeshtë, duke supozuar se në periudhën që vjen të dyja vendet do të ruajnë të njëjtat norma inflacioni, do të kishim që për muajin raportues m_{12} norma p_v e vendit x do të ishte:

$$P_{vx} = p_m(m_1) + p_m(m_2) + \dots + p_m(m_{12}) = 24\%,$$

ndërkohë që supozuam se për vendin y norma p_{vy} mbetet e pandryshuar në nivelin 2 për qind, e matur si ndryshim relativ i nivelit të indeksit të çmimeve në periudhën m_{12} me nivelin e po këtij indeksi në muajin m_1 . Informacioni i mësipërm është i mjaftueshëm për të krijuar përshtypjen se për ato kategori vendesh me inflacion kronik (siç është vendi x), norma mujore e tij është një tregues që mat më mirë efektivitetin e politikave ekonomike dhe financiare për vënien nën kontroll të tij. Edhe pse informacioni i siguruar mbulon një periudhë shumë afatshkurtër, përsëri për një ekonomi në emergjencë merr një rëndësi më të madhe se çfarëdo lloj tjetër informacioni për periudha më afatgjata. Krejt ndryshe, për vendet me ekonomi të stabilizuara (siç është vendi y), norma mujore e inflacionit është një e dhënë me informacion jo shumë të dobishëm dhe për këtë arsye, në shumicën e rasteve, referimi i bëhet normës vjetore të inflacionit. Imagjinoni sikur në buletinet e agjencive të specializuara në SHBA të lexonit se vetëm gjatë një muaji, niveli i përgjithshëm i çmimeve të konsumit, në Amerikë është rritur me 2 për qind.

Në rastin e Shqipërisë, në vitet e para e tranzicionit, rëndësi e madhe i kushtohet uljes së normës mujore të inflacionit në nivele njëshifrore, pasi normat mujore të inflacionit ishin në nivele të larta. Me kalimin e kohës, me vendosjen e inflacionit nën kontroll, objektivi mbi inflacionin u zhvendos nga norma mujore e inflacionit mbi atë vjetore, dhe më konkretisht mbi normën vjetore në muajin e fundit të vitit ushtrimor. Në këtë pikë është momenti që të sqarojmë dhe një detaj tjetër, që ka të bëjë me futjen e nocionit mesatar në matjet e ndryshme që i bëhen inflacionit.

Për shumë shkaqe qëllon që norma mujore e inflacionit të jetë e ndryshme nga njëri muaj në tjetrin. E njëjta gjë ndodh edhe me normën vjetore të tij. Për të qenë pak më konkretë, në qoftë se do të zgjedhim si objektivi për inflacionin normën vjetore të tij në fund të vitit, atëherë “padrejtësisht” do të linim jashtë atë “sasi” inflacioni, e cila gjatë periudhës ushtrimore ka qenë e pranishme vetëm në disa muaj të vitit ushtrimor ose anasjelltas. A mund të themi, për shembull, që inflacioni në vitin 2000 ka qenë 4.2 për qind (dhjetor 2000) ndërkohë që për pjesën më të madhe të vitit norma vjetore e tij ka qenë në nivele afër zeros? Përveç faktit që norma e rezultuar në fund të dhjetorit 2000, është thjesht një matje e inflacionit të cilën Banka e Shqipërisë e ka adoptuar për të shprehur efektivitetin e politikës së saj, kjo normë, në asnjë mënyrë nuk mund të përdoret për të përshkruar zhvillimet inflacioniste gjatë vitit 2000. Pa dyshim që një përjasje më e mirë, edhe për publikun, do të ishte përcaktimi i një norme mesatare vjetore të inflacionit (një mesatare e thjeshtë arithmetike e normave vjetore të inflacionit të regjistruar në çdo muaj të vitit ushtrimor). Kuptimi ekonomik i kësaj norme do të ishte se paratë e shqiptarëve u zhvlerësuan me 0 për qind mesatarisht gjatë vitit 2000. Në qoftë se do të kishim llogaritur normën mesatare mujore të inflacionit, do të kuptonim se mesatarisht paratë e shqiptarëve e kanë humbur vlerën e tyre me 0.4 për qind çdo muaj. Tabela 3, pasqyron normën vjetore të inflacionit në fund të çdo viti ashtu sikurse dhe vlerën e tij mesatare të çdo viti. Lexuesit, shpresojmë se do të jenë në gjendje të komentojnë vetë rezultatet e përfutuara.

Tabela 3. Normat mesatare të inflacionit ndër vite.

Dhjetor '93 = 100	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000
Norma Vjetore e Inflacionit									
Në fund të periudhës	236.6%	30.9%	15.8%	6.0%	17.4%	42.1%	8.7%	-1.0%	4.2%
Mesatare	n.a.	109.2%	23.0%	8.0%	12.8%	32.9%	21.6%	0.4%	0.0%
Norma Mujore e Inflacionit									
Në fund të periudhës	1.3%	0.3%	1.9%	0.7%	0.7%	2.3%	2.1%	2.2%	4.6%
Mesatare	11.1%	2.3%	1.3%	0.5%	1.4%	3.0%	0.7%	-0.1%	0.4%

Nga shembulli i përdorur me ecurinë e inflacionit në dy vende të ndryshme imagjinare x dhe y, bëjmë një supozim se norma e inflacionit, pavarësisht nëse ishte mujore apo vjetore, qëndronte konstante me kalimin e kohës. Në të vërtetë nuk ndodh kështu. Inflacioni luhatet vazhdimisht në kohë. Diku ai shfaqet me hapa të përshpejtuar, dhe diku tjetër ecën më ngadalë, ndoshta duke rënë dhe në momente monotonie, por edhe këto të përkohshme. Analistët, duke kthyer kokën nga e kaluara, mund të përcaktojnë dhe intervalin e besueshëm kohor për çdonjë nga fazat që përshkruam më sipër. Megjithatë, në analizat e tyre specialistët nuk kanë si të lënë jashtë vëmendjes dhe faktorë të tjerë, respektimi skrupuloz i të cilëve është i rëndësishëm për kanalizimin e inflacionit në hullitë e dëshiruara nga vendimmarrësit.

Në të vërtetë, ajo që duam të themi nuk ka të bëjë as me konceptimin e ndonjë modeli makroekonomik, as me trajtime teorike të inflacionit por: së pari ka të bëjë me evidentimin e faktit se inflacioni është një variabël makroekonomik i cili ndryshon në vazhdimësi gjendjen e tij; së dyti ka të bëjë me “zhveshjen” e këtij ndryshimi të pandërprerë nga ndikimet rastësore dhe sezonale; dhe së fundi ka të bëjë me përcaktimin e tendencës së përgjithshme nga prirjet ky ndryshim i “zhveshur”. “Zhveshja” e ecurisë së inflacionit nga goditjet e rastësishme të paparashikuara, është një tentativë e njohur, e cila përpiket të zbulojë atë përbërës të qëndrueshëm, që në mënyrë të përhershme pasqyron “mëkatet” e politikës monetare, dhe që në literaturë njihet si inflacioni “bazë”. Përveç goditjeve të rastit, të cilat më së shumti janë jashtë kontrollit dhe dëshirës së autoriteteve vendimmarrëse, ndodh që çmimet e mallrave të konsumit, në një periudhë të caktuar të çdo viti, të pësojnë rritje ose ulje të nivelit të tyre të përgjithshëm. Megjithëse intensiteti i ndryshimit mund të variojë nga një vit në tjetrin ajo çka është më e rëndësishme, ka të bëjë me faktin se kahu për nga prirjet ndryshimi është i njëjtë, duke i bërë autoritetet vendimmarrëse që të kenë një lloj dijeje paraprake për zhvillimet e së ardhmes.

Për të qenë pak më konkretë, do të citonim një fenomen tashmë të pranuar në Shqipëri: efektin që ka dalja e prodhimit bujqësor vendas në tregun e brendshëm, gjatë periudhës qershor – korrik. Prodhimi vendas, me daljen në treg, ndikon në uljen e shumicës së çmimeve të produkteve bujqësore, duke kontribuar në një ulje të nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Po kështu, çdo fundviti, festat tradicionale po kthehen në një faktor me ndikim të pastër stinor mbi çmimet në përgjithësi, përderisa kërkesa për mallra konsumi rritet shumë, ndërkohë që gjatë muajve në vijim (janar – shkurt), vendi përjeton një tkurrje të përgjithshme të aktivitetit ekonomik (përfshirë dhe kërkesën për mallra konsumi), e për rrjedhim kemi të bëjmë me një ngadalësim në rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve. E gjitha kjo që thamë më sipër, në literaturë njihet si efekti i ndikimit të sezonit mbi ecurinë e çmimeve të konsumit, efekt i cili është mirë që të hiqet nga norma aktuale e inflacionit. Ky “pastrim” është i domosdoshëm sa herë që na nevojitet “të luajmë” më tej me inflacionin, sa herë që kërkojmë të dimë se cila është tendenca që e karakterizon atë, sa herë që kërkojmë të parashikojmë ecurinë e tij në të ardhmen, sa herë që kërkojmë të shpjegojmë ndërvarësinë e tij me variabla të tjerë makroekonomikë etj.. Është e kuptueshme që saktësia në matjen e efektit stinor varet nga numri i vrojtimeve, i cili është mirë të jetë i madh dhe të mbulojë mundësisht shumë vite me rradhë. Sa më i madh numri i viteve aq më e madhe është dhe saktësia që mbartin koeficientët korrigjues të sezonalitetit.

Së fundmi duhet theksuar se sezonaliteti ka kuptim për aq kohë sa i referohemi normës mujore apo asaj tremujore të inflacionit, për arsyen e thjeshtë, se efekti sezonal nuk bën gjë tjetër veçse sheshon ndryshimet mujore apo tremujore të inflacionit me anë të koeficientëve korigjues, shuma e të cilëve duhet të jetë zero. Pra, në qoftë se i referohemi normës vjetore të inflacionit efekti sezonal është automatikisht i përjashtuar. Si do të dukej grafiksht ndryshimi midis normës faktike mujore të inflacionit dhe asaj të korigjuar sezonalisht për periudhën dhjetor 1999 – gusht 2001?

Figurë 3. Ndryshimi 3 - mujor i IÇK.



Dallimi ilustruhet në figurën 3, e cila pasqyron ecurinë e normës mujore aktuale dhe të asaj të korigjuar. Vihet re qartë se vija e verdhë, e cila përfaqëson normën mujore të inflacionit të korigjuar sezonalisht, në të gjitha rastet ka zbutur ndjeshëm luhatjet ekstreme të inflacionit aktual (vija blu), duke prodhuar një kurbë më të lëmuar të ndryshimit të çmimeve.

Në praktikë, ashtu si sëmundjet, edhe inflacioni shfaqet me nivele të ndryshme të prekjes, megjithatë, studiuesit, sidomos kur bëhet fjalë për ta dalluar atë nga ana sasiore, kanë arritur të identifikojnë katër lloje inflacioni: inflacion të ulët, inflacion të moderuar, inflacion galopant dhe

hiperinflacion. Në literaturën e sotme **inflacioni i ulët** nënkupton një normë pozitive inflacioni, që luhatet në intervalin 0 - 4 për qind në bazë vjetore. Që në momentin e parë çdokush mund të mendojë se bëhet fjalë për një normë inflacioni që është tipike për vendet e zhvilluara.

Inflacioni i moderuar përpara dy dekadash nënkuptonte një inflacion njëshifror, i cili në ekstremin e sipërm të tij kishte një normë vjetore në masën 10 për qind. Aktualisht, bëhet fjalë për një normë vjetore inflacioni që luhetet në intervalin 5 - 10 për qind dhe që aktualisht, është tipike për një pjesë të ekonomive në zhvillim dhe për ato në tranzicion. Nga një këndvështrim pak më teknik, ky lloj inflacioni është i pranishëm në ato periudha kur “terapitë” e përdorura në kohë krizash kanë filluar të japin efektin e tyre. Megjithatë, në disa raste, sidomos, kur pas periudhash relativisht të gjata të një inflacioni të ulët vihet re një përshpejtim konstant i inflacionit, që e çon atë një nivel më lart, mund të thuhet se kanë filluar të bien këmbanat e alarmit.

Inflacioni quhet **galopant** atëhere kur çmimet në bazë vjetore rriten me përqindje me dy ose tre shifra. Në këtë situatë janë ndodhur shumica e vendeve

në tranzicion në fillimin e viteve '90, pas shturjes së bllokut të madh komunist në Evropë. Në ambiente ekonomike ku çmimet dyfishohen ose trefishohen në harkun kohor të një viti, problemet janë të shumta dhe jeta e individëve, e firmave, pra e agjentëve ekonomikë në përgjithësi, bëhet shumë e vështirë. Ky inflacion shoqërohet me prishje të stabilitetit makroekonomik duke çuar në rënien e prodhimit, në përkeqësimin e pozicionit valutor, në shkatërrimin e kursimeve, në dollarizimin e ekonomisë, e në shumë fenomene të tjera negative.

Ndërkohë që ekonomia edhe mund të mbijetojë nga një inflacion galopant, nuk ka dyshim se **hiperinflacioni** për të është një kancer i vërtetë. Përveç të kaluarës së largët, kur Gjermania u godit nga një hiperinflacion i egër – vitet 1922 - 24 – një periudhë të gjatë dhe të vështirë hiperinflacioni përjetuan dhe shumica e ish-Republikave të Bashkimit Sovjetik në fillimin e viteve '90.

SHTOJCË 3. INFLACIONI NË SHQIPËRI.


Grafiku i çmimeve gjatë pesëvjeçarit të fundit para vitit 1990 ka qenë krejt indiferent, sepse çmimet e brendshme ishin tërësisht të izoluar nga ato ndërkombëtare dhe nuk shprehnin koston reale të prodhimit. Çdo diferencë ndërmjet çmimeve fikse me shumicë dhe atyre reale paguhej nga buxheti i shtetit duke çuar në një deficit fiskal që akumulonte inflacion të fshehur, i cili shpërtheu pas vitit 1991. Pas këtij “stabiliteti”, në nëntor të vitit 1991, u liberalizuan zyrtarisht disa çmime konsumi. Deri në gjysmën e parë të vitit 1992 mbeti nën kontroll vetëm një shportë relativisht e vogël produktesh. Në dhjetor të vitit 1992 çmimet ishin 3.4 herë më të larta se ato të dhjetorit të vitit 1991 dhe afro 7 herë më të larta se ato të fundit të vitit 1990. Gjysma e dytë e vitit 1992, shënoi përpjekjet e para serioze për të ndaluar rënien e mëtejshme të prodhimit në vend dhe sigurisht dhe vënien nën kontroll të inflacionit. Një paketë masash emergjente e adoptuar nga autoritetet, çoi në një frenim të menjëhershëm të zhbilancimit të mëtejshëm të ekuilibrit makroekonomik.

Inflacioni galopant i viteve 1990 – ‘92 filloi të bjerë, vit pas viti, duke arritur nivele njëshifrore në fund të vitit 1995. Rritja e menjëhershme e përqindjes së interesit dhe kontrolli i vendosur mbi kredinë për ekonominë bënë që të ndalohej hemorragjia e madhe monetare dhe në fund të vitit 1995, rritja e çmimeve të konsumit të ishte vetëm 6 për qind.

Periudha dyvjeçare në vijim përkon me “lulëzimin” dhe “perëndimin” e firmave piramidale. Përqindjet e larta të firmave “zëvendësuan” totalisht përqindjen e interesit të ofruar nga sistemi bankar e, për rrjedhim, efektiviteti i politikës monetare u reduktua ndjeshëm. Si përfundim, në fund të vitit 1996, inflacioni rezultoi 3 herë më i lartë nga ai i vitit paraardhës duke reflektuar një rritje të madhe të kredisë dhënë qeverisë nga ana e sistemit bankar. Pasojat e falimentimit të firmave rentiere ishin të gjithanshme dhe, për pasojë, ato nuk mund të linin pa ndikuar dhe inflacionin, i cili në fund të vitit 1997 shënonte 42 për qind në bazë vjetore.

Periudha 1999 - 2000, regjistroi përqindje të pazakonta inflacioni për një ekonomi si ajo e Shqipërisë. Edhe pse gjatë vitit 1999 Shqipëria u detyrua të përballonte eksodin biblik të popullsisë së Kosovës, përsëri inflacioni mbeti në kuota të ulëta. Ndoshta dhe vetë kriza u shndërrua në një faktor shock që ndihmoi në uljen e presioneve inflacioniste në ekonomi.

Figurë 4. Norma vjetore e inflacionit.



Megjithatë, muaji i fundit i vitit 2000, duket se dha sinjalin e parë për përfundimin e periudhës deflacioniste pasi ai regjistroi një normë mujore prej 4.6 për qind. Periudha në vazhdim deri në ditët tona është karakterizuar vazhdimisht nga përqindje pozitive, të cilat megjithëse brenda intervalit kufi, përsëri kanë një tendencë në rritje. Kjo tendencë u bë veçanërisht e fuqishme në muajin korrik 2001, kur inflacioni në bazë vjetore kapërceu limitin e sipërm të intervalit kufi duke u ndalur në 5.6 për qind.

INFLACIONI: A ËSHTË AI NJË FENOMEN MONETAR?

Më sipër e përkufizuam inflacionin si një rritje e nivelit të përgjithshëm të çmimeve, ndërkohë që theksuam se inflacioni është i pranishëm kur kemi “superprodhim” parash. Pra, me këtë shprehje të fundit kemi filluar përpjekjet për identifikimin e faktorëve që prodhojnë inflacion. Lidhja e parasë me inflacionin është e vjetër dhe fakti që sasia e parasë në qarkullim përcakton dhe nivelin e çmimeve në ekonomi është njohur dhe nga grekët e vjetër. Në shekullin XX, pikëpamjet teorike mbi lidhjen e parasë me inflacionin kanë qenë në ndryshim të vazhdueshëm. Irving Fischer (1922 – teoria sasiore) arriti në përfundimin se ndryshimet në sasinë e parasë shkaktonin ndryshime në nivelin e çmimeve, teori e cila u mbështet dhe u zhvillua më tej nga monetaristë të tjerë. Milton Friedman argumentoi se inflacioni fillon të përshpejtohet sa herë që përshpejtohet dhe rritja e ofertës së parasë.

Në këtë këndvështrim ai arriti në konkluzionin se “inflacioni gjithnjë dhe kurdoqoftë është një fenomen monetar”.

Ndërkohë Kejnisi (1959 – Radcliffe Report) i atribuon parasë një rol pak më të zbehtë, duke vënë theksin dhe në faktorë të tjerë si politika fiskale, tronditjet në ofertën agregate etj.. Megjithatë, edhe ai në një analizë të fundit shpjegon se inflacioni i lartë shkaktohet nga rritja e madhe e ofertës së parasë dhe se faktorët e tjerë janë kryesisht faktorë, të cilët mund ta ndikojnë inflacionin vetëm përkohësisht.

Ajo çka u tha më sipër lidhet me ato raste kur inflacioni është gjithnjë në rritje të shpejtë. Edhe ato evidenca empirike që tregojnë një lidhje perfekte midis rritjes së parasë dhe inflacionit bëjnë fjalë pikërisht për periudha të trazuara, kur inflacioni mund të kategorizohet si galopant apo si hiperinflacion. Në fakt, e gjitha kjo më sipër nuk është ajo çka ne dëgjojmë në lajme apo në organe të tjera të medias. Nga media informohemi thjesht për masën e rritjes së nivelit të çmimeve, në përqindje, në krahasim me muajin e mëparshëm. Për shembull, kur dëgjuat se inflacioni në muajin dhjetor 2003, ishte 3.2 për qind ju duhet të kuptoni se niveli i çmimeve të konsumit gjatë atij muaji u rrit me 3.2 për qind. Në argumentet e dhëna nga institucionet

përgjegjëse, u paraqitën si shkaqe të mundshme, efekti sezonal, spekulimet e rrjetit të tregtisë me pakicë, kriza energjitike etj.. Marrja në konsideratë e shkaqeve të mësipërme na çon në përfundimin se kjo rritje ka qenë e përkohshme, pasi efektet e faktorëve të mësipërm janë të tillë, që ushtrojnë ndikimin e tyre vetëm një herë – në kohën kur ata ndodhin. Dhe realisht 2 muajt në vazhdim, duket se amortizuan inflacionin mujor të dhjetorit 2000, pasi të dy prodhuan norma mujore negative inflacioni.

Atëhere kur duhet të shqetësohemi? Proceset e formimit të inflacionit në ekonomi bëhen të rrezikshme kur përbërësi i përcaktuar më sipër si “i përkoshëm” shndërrohet në “i përhershëm”. Imagjinoni sikur për një periudhë dymbëdhjetëmujore, ekonomia çdo muaj të prodhonte një inflacion mujor në nivelin 1 për qind. Atëherë, për të gjithë periudhën, rritja e inflacionit – inflacioni vjetor – do të ishte 12 për qind, një normë kjo aspak e pëlqyeshme jo vetëm për ekonomistët, por edhe për xhepat e individëve.

INFLACIONI: SI SHKAKTOHET AI?

Më sipër shpjeguar se inflacioni është një fenomen monetar, ndërkohë që të drejtën ekskluzive për të emetuar para në një mjedis real e kanë bankat qendrore. Pra, në pamje të parë, të krijohet përshtypja se banka qendrore, me politikën e saj, është një nga shkaktaret kryesore të inflacionit. Kjo është e vërtetë. Sidomos në ditët e sotme, bankat qendrore gjithnjë e më shumë po konsiderohen përgjegjëse për kontrollin e inflacionit dhe për këtë arsye, numri i bankave qendrore që kujdesen vetëm për stabilitetin e çmimeve të konsumit është gjithnjë në rritje. Sa vjen e më tepër po mbizotëron ideja se, stabiliteti i çmimeve është kontribuesi më i mirë edhe për realizimin e objektivave të tjerë që kanë të bëjnë me rritjen ekonomike, punësimin etj..

Pra, duke përgjithësuar mund të arrijmë në konkluzionin se politika monetare me aftësinë apo paaftësinë e saj, mund të kontrollojë, pra të ngadalësojë ose të përshpejtojë rritjen e nivelit të çmimeve ekonomi. Si e realizon ajo këtë?

Në praktikë gjërat nuk janë kaq të

thjeshta. Megjithatë, ajo që qëndron në parim është aftësia e bankës qendrore për të kontrolluar ofertën e parasë. Me anë të instrumenteve që ka në dispozicion, ajo mund të tërheqë apo të injektojë para në ekonomi në përputhje me kërkesat që mund të ketë ekonomia.

Në një ekonomi tregu kjo gjë realizohet thjesht, mjafton të kujtojmë aftësinë tjetër të bankës qendrore për manipuluar çmimin e parasë – përqindjen e interesit. Duke rritur përqindjen e interesit, politika monetare synon të shtrenjojë çmimin e kredisë, veprim i cili do të çojë në uljen e kërkesës. Kështu, paraja që nuk kërkohet si kredi, do të rrijë në arkat e bankës qendrore. Veprimi i anasjelltë nënkupton një vendim të bankës qendrore për të rritur sasinë e parasë që do t'i injektohet ekonomisë, e për pasojë dhe pritjet inflacioniste duhet të shtohen në ekonomi.

Siç pamë më sipër kontrolli mbi çmimin e kredisë – përderisa ajo përbën kanalin kryesor për rrjedhjen e parasë në ekonomi – merr një kuptim të veçantë kur flasim për kontrollin e presioneve inflacioniste në ekonomi. Në këtë pikë kemi arritur

në një moment shumë të rëndësishëm: në citimin e atij inflacioni që shkaktohet nga ekspansioni i kredisë në ekonomi – kredi që mund të marrë një individ, një kompani, një institucion tjetër çfarëdo etj..

Duke parë dokumentet statistikore të Bankës së Shqipërisë bie në sy, se një përdorues i fuqishëm i kredisë së sistemit bankar është dhe Qeveria ose siç njihet ndryshe buxheti. Për aq kohë sa kjo e fundit është e aftë të mbulojë vetëm pjesërisht shpenzimet buxhetore, ajo do të drejtohet në tregjet ku ofrohen para borxh. Ndryshe nga shumë vende të tjera, në Shqipëri, Qeveria mund të huazojë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga banka qendrore, domethënë e financon deficitin buxhetor me prerje të re të parasë duke rritur në këtë mënyrë presionet inflacioniste në ekonomi.

Pra, mënyra se si qeveria financon deficitin buxhetor mund të jetë dhe ajo në vetvete një burim i mundshëm inflacioni, sidomos kur deficitin buxhetor në mënyrë të qëndrueshme është i lartë dhe po në mënyrë të qëndrueshme ky deficit nuk i shitet publikut, por mbulohet me shtypje të re të parasë. Ka evidenca

më se të mjaftueshme se në të gjitha rastet e hiperinflacionit, shkaktarët kryesorë të tij kanë qenë deficitet e mëdha buxhetore dhe financimi i tyre nëpërmjet shtypjes së parave.


Siç pamë më sipër, inflacioni në disa raste mund të jetë pasojë e një politike monetare ekspansioniste dhe në disa raste të tjera, sidomos në ekonomitë në zhvillim, inflacioni mund të rrjedhë thjesht nga arbitrariteti i qeverisë për të financuar deficitin buxhetor me printim të ri parash.

Në të dyja rastet nuk bëhet gjë tjetër, veçse rritet më tej kërkesa e përgjithshme e ekonomisë për mallra dhe për shërbime, e cila në kushtet kur nuk pasohet nga i njëjti ritëm i rritjes së kapaciteteve prodhuese – ofertës – i vendos çmimet kundrejt një presioni të fortë në rritje. Një ilustrim i kësaj situatë është akoma i freskët në Shqipëri. Mjafton të kujtojmë vitin 1996, kur presionet inflacioniste në ekonomi u shtuan në mënyrë të dukshme në fund të vitit, si rezultat i rritjes së fuqishme të kërkesës së brendshme për mallra dhe për shërbime – shtojca 4.

SHTOJCË 4. KRIZA E VITIT 1996.

Viti 1996, për nga shumëllojshmëria e zhvillimeve ekonomike, politike dhe sociale, është pa dyshim një pikë kthese, një vit që në njëfarë mënyre përmbysi gjithçka të mirë që ishte arritur në vitet e para të tranzicionit. Shenjat e para të depozitimit të parave në firma të ndryshme (pa bërë dallim nëse ato ishin të angazhuara në aktivitete prodhuese) u vunë re që në vitin 1995 e ndoshta më herët. Ndërkohë që shenjat e para të ekspansionit të deficitit buxhetor përkojnë me gjashtëmujorin e dytë të vitit 1995. Si rezultat i indiferencës së plotë në trajtimin e tyre, i aplikimit të politikave të shtrënguara të kreditit, i mungesës totale të një tregu të rregulluar kapitalesh, i injorimit të kursimeve të individëve etj. çmenduria e investimit në këto firma kapërceu çdo kufi, duke gllabëruar qindra milionë dollarë amerikanë. I parë në këndvështrimin politik, lulëzimi i këtyre skemave të investimit, koïncidoi me një vit të ngjeshur elektoral, që përveç përkrahjes morale që iu dha skemave piramidale, u tregua dorëlëshuar në shpenzime. Interesat e lartë që paguheshin ishin aq tërheqës, sa që pre e këtyre skemave filluan të binin jo vetëm rezidentët, por edhe emigrantët si dhe një numër i konsiderueshëm të huajsh. Shfaqja e fenomenit fajde i bëri shqiptarët të harronin varfërinë e tyre të tejskajshme dhjetravjeçare dhe krijoi iluzionin e një shoqërie të pakufizuar konsumi. Kërkesa e brendshme njohu rritje të paparë, në përgjigje të së cilës, në mungesë të kapaciteteve të brendshme prodhuese, pati një vërshim të paimagjinueshëm mallrash importi, ku nuk përjashtoheshin edhe mallrat e luksit.

Figurë 5. Llogaritë fiskale (në % ndaj PBB-së).



Rritja e madhe e agregatit të kërkesës, në mënyrë të pashmangshme, çoi në rritjen e presioneve mbi çmimet e konsumit. Inflacioni në fund të vitit 1996 ishte pothuaj 3 herë më i lartë se një vit më parë dhe premiset për rritje të mëtejshme ishin gjithnjë e më të pranishme. Muaji i fundit i vitit 1996, me pak fjalë, konturoi tiparet themelore të atij tërmeti ekonomiko-politik që pasoi në muajt në vazhdim.

Por, mund të ndodhë edhe e kundërta, që edhe pse kërkesa e përgjithshme është nën kontroll – rritet me ritme natyrale – për shkaqe të papritura ose të pastuduara më parë oferta e përgjithshme, pra ajo çka ofrojnë kapacitetet prodhuese të ekonomisë, të pësojë rënie. Për rrjedhim, prishja e ekuilibrit momentalisht mund të shkaktojë një rritje të çmimeve. Mund

të ndodhë që për arsye të ndryshme – protesta sindikaliste – zërat që formojnë koston e produkteve – pagat – të rriten e, për rrjedhim kjo do të çojë në një rritje të çmimit të atij produkti. Pavarësisht kësaj, duhet theksuar se në të dyja rastet kemi të bëjmë me faktorë që ndikojnë rritjen e çmimit vetëm një herë, në momentin që ata bëhen efektivë – shtojca 5.

SHTOJCË 5. KRIZA ENERGJITIKE DHE NDIKIMI I SAJ MBI INFLACIONIN.

Për disa vite rradhazi, vendi ynë po përjeton një situatë të vështirë të prodhimit dhe të furnizimit me energji elektrike, e cila thuhet se origjinën e ka në thatësinë që ka pushtuar vendin tonë këto vitet e fundit. Pa u ndalur në shkaqet që gjenerojnë këtë krizë, do të përqendrohemi në ndikimet negative të saj sidomos në drejtim të përshpejtimit të inflacionit në ekonomi. Për të arritur në konkluzione më të qarta, do të ngremë dhe një paralele tjetër: krizën energjitike që përjetoi shteti i Kalifornisë në SHBA, dy vite më parë. Për të dyja vendet problemi ishte i njëjtë, domethënë nuk janë në gjendje të prodhojnë aq shumë energji sa kërkohet për t'u konsumuar.

Po ndryshimet ku vërehen? Pikë së pari, çmimi i energjisë elektrike në Shqipëri është i kontrolluar ndërsa në Kaliforni ai vendoset nga parimet e tregut; së dyti, energjia e konsumuar në Shqipëri, në një masë të madhe vidhet, e po në një masë të madhe humbet nëpër rrjetet e amortizuara të shpërndarjes, ndërkohë që në Kaliforni kjo gjë as që mund të mendohet; së treti, në Shqipëri rrjeti shpërndarës nuk është i aftë të kompensojë – nëpërmjet importit – atë pjesë të energjisë që nuk plotësohet nga prodhimi i brendshëm, ndërkohë që kjo gjë nuk ndodh në Kaliforni.

Ku është ndryshimi më i madh në këtë rast? Pa dyshim ai duhet gjetur tek mosfunksionimi i mekanizmit “të artë” të ekonomisë së tregut që balancon automatikisht mospërputhjet e kërkesës me ofertën: vendosja e lirë e çmimit në treg. Në rastin e Kalifornisë mekanizmi i mësipërm bën që çmimi i energjisë të rritet duke ndikuar drejtpërdrejt si në rritjen e shpenzimeve të individëve ashtu edhe në rritjen e kostos së produkteve për aq kohë sa energjia elektrike është një zë i rëndësishëm i kostos.

Tek ne, ndryshe nga sa më sipër, meqënëse çmimi është i kontrolluar dhe kapaciteti importues është po ashtu i kufizuar, do të kemi ulje të ofertës për energji, që do të thotë mosplotësim i nevojave për energji elektrike, edhe pse mund të supozojmë se biznesi do të ishte i gatshëm ta përdorte atë kundrejt çdo çmimi. Si reagon biznesi në këto kushte?

Ka tre rrugë: ose do të përpiqet të gjejë burime alternative energjie; ose do të ulë prodhimin; ose do të detyrohet ta mbyllë atë. Alternativa e parë nënkupton përdorimin e burimeve të tjera, të cilat për vetë situatën e krijuar aplikojnë çmime të larta, gjë që çon në rritje të kostos; në alternativën e dytë çmimet do të rriten përsëri, për aq kohë sa prodhimi pëson rënie duke krijuar zbalancim të kërkesës me ofertën. Në alternativën e tretë zbalancimi kërkesë ofertë do të jetë akoma më i madh e, për rrjedhim, dhe çmimet mund të rriten me intensitet më të lartë. Pra, në rastin e Shqipërisë edhe pse efekti nuk është aq i drejtpërdrejtë sa në rastin e Kalifornisë, përsëri presioni në rritje mbi çmimet është i pranishëm dhe në qoftë se kjo krizë do të vazhdojë më tej, efekti i saj nuk do të ketë më natyrën e një fenomeni shock të përkohshëm, por përkundrazi do të shndërrohet në një burim të qëndrueshëm inflacioni.

INFLACIONI: KUSH PËRGJIGJET PËR TË?

Kujt duhet t'i kërkojmë llogari për inflacionin? Thamë që një pjesë e madhe e bankave qendrore në qendër të aktivitetit të tyre kanë ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Po ashtu, sqaruar se inflacioni është “mëkat” i politikës monetare për aq kohë sa ekspansioni monetar nuk imponohet prej zbatimit të politikave fiskale të papërgjegjshme. Në këto kushte, lidhja para – inflacion është shumë e fortë dhe merr formën e një spiraleje në të cilën një element shtyn tjetrin dhe anasjelltas.

Duke u kthyer edhe një herë në botën reale, do të donim të sqaronim se jeta e bankierëve qendrorë po bëhet gjithnjë e më e vështirë. I gjithë opinioni i mban sytë tek ata; cila do të jetë lëvizja e tyre e ardhshme; nëse interesi do të rritet siç pritej nga tregjet apo jo; nëse veprimi i marrë ishte në kohën e duhur apo jo, nëse mesazhi do të përcillet me shpejtësinë e duhur etj.. Presioni publik mbi ta është më i fortë në vendet e zhvilluara, por realisht jeta e tyre është më e koklavitur në vendet e pazhvilluara.

Përse ndodh kështu? Sigurisht përgjigja e kësaj pyetjeje është një e vetme: pavarësia e bankës qendrore, e cila është vërtet reale në demokracitë perëndimore dhe është gjithnjë nën kërcënim dhe shpesh, edhe formalisht jo e plotë, në vendet në zhvillim. Nga vrojtime të shumta ka rezultuar se bankat qendrore me shkallë të lartë pavarësie kanë arritjet më të mira në sfidën me inflacionin, ashtu siç është vërejtur e kundërta në shumicën e vendeve ku shkalla e pavarësisë së bankave qendrore lë për të dëshiruar.

Sot, gjithnjë e më tepër po vërtetohet se sigurimi i stabilitetit të çmimeve është kontributi më i çmuar që një bankë qendrore mund të japë për zhvillimin ekonomik afatgjatë të vendit. Duke u nisur nga kjo, ndjekja e këtij objektivi shpesh kërcënohet nga interesa afatshkurtër siç janë rritja shumë e shpejtë ekonomike, punësimi i lartë etj., të cilat sigurohen “duke falur” disa pikë përqindjeje nga inflacioni ose duke toleruar një inflacion të lartë. Por, përfitimi afatshkurtër është edhe dritëshkurtër. Ai kthehet në një bumerang për ekonominë, për stabilitetin dhe për zhvillimin e saj në periudhë

afatgjatë. Për këtë arsye, ky objektivi i besohet bankave qendrore, të cilat, ndryshe nga qeveritë apo nga politikanët, nuk kanë arsye të prirën nga përfitimet apo nga interesat afatshkurtër.

T'i njohësh me ligj bankës qendrore të drejtën që të ketë si objektivi stabilitetin e çmimeve nuk do të thotë që banka do ta realizojë atë. Banka qendrore nuk mund të bëjë asgjë pa patur pavarësi të plotë nga ekzekutivi për ta ndjekur këtë objektivi dhe

për të përdorur instrumentet që ajo vetë zgjedh për zbatimin e politikës monetare. Nëse, me ligj bankës qendrore i njihet si objektivi kryesor stabiliteti i çmimeve, por nga ana tjetër ligji parashikon që banka qendrore në çdo kohë është e detyruar të kreditojë drejtpërdrejt qeverinë me çdo lloj shume, atëherë banka qendrore nuk do të jetë në gjendje ta realizojë këtë objektivi. Në këtë mënyrë, suksesi i bankës qendrore në realizimin e detyrave të saj varet nga shkalla e pavarësisë që ajo gëzon.

SHTOJCË 6. PAVARËSIA E BANKËS SË SHQIPËRISË.

Tashmë të gjithë e dinë se objektivi i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve ose më konkretisht, mbajtja e normave të ulëta pozitive të inflacionit. Politika monetare që harton dhe zbaton Banka e Shqipërisë është në funksion të këtij objektivi. Në fakt, një objektivi i tillë ndiqet nga shumë banka qendrore në botë. Pavarësia e bankës qendrore varet nga mjaft faktorë. Në rastin e Shqipërisë vlerësohet se banka qendrore gëzon një pavarësi të lartë ligjore. Por, pavarësia reale e saj ende lë për të dëshiruar. Ka një sërë faktorësh, objektivë dhe subjektivë, që çojnë në reduktimin e pavarësisë reale:

Paqëndrueshmëria politike.

Besohet se paqëndrueshmëria politike ka ndikim në pavarësinë e bankës qendrore. Mosrespektimi i rregullave të lojës politike dhe të kalimit të pushteteve, sjell edhe ndikime të fuqishme të paqëndrueshmërisë politike në pavarësinë e bankës qendrore. Në Shqipëri, të dyja situatat e përshkruara më sipër kanë ekzistuar dhe kanë patur ndikimet e veta në pavarësinë e Bankës së Shqipërisë.

Pak a shumë, mund të thuhet që është vërejtur paqëndrueshmëri politike si pasojë e mbajtjes së 4 zgjedhjeve dhe dy referendumeve për kushtetutën, në një interval kohor prej 8 vjetësh (normalisht duhet të kishim dy zgjedhje). Po kështu, në momentet kur forcat politike në pushtet kanë ndjerë se do të largoheshin prej tij nga zgjedhjet e parakohshme, temë e ditës së tyre ka qenë “respektimi i institucioneve dhe i teknokratëve”, përfshi Bankën e Shqipërisë. Në tërësi, paqëndrueshmëria politike ka ndikuar në drejtim të reduktimit të pavarësisë së bankës.

Zhvillimi i tregut financiar.

Në rastin e Shqipërisë, mund të thuhet me siguri të plotë se pavarësia e bankës qendrore dëmtohet dhe nga shkalla e ulët e ndërmjetësimit financiar dhe nga mungesa e tregjeve të kapitalit. Kjo bën që në ekonominë e vendit pesha e sektorit financiar të mos jetë e konsiderueshme dhe për pasojë edhe veprimet e vendimet e bankës qendrore të mos japin efektin maksimal të tyre.

Borxhi i brendshëm.

Ekzistenca e një borxhi të madh të brendshëm të qeverisë, bën që klasa politike të mos jetë e interesuar për një bankë qendrore të pavarur. Shqipëria, ka një borxh të brendshëm relativisht të lartë që, gjithashtu, kufizon pavarësinë reale të bankës qendrore.

Operacionet në tregun e hapur.

Një bankë qendrore ka pavarësi më të lartë nëse ajo ka hapësirat e nevojshme dhe aftësinë për të ndërhyrë në masë të mjaftueshme në tregun e hapur kur një gjë e tillë nevojitet. Por, kjo aftësi dhe për pasojë, dhe pavarësia e bankës kufizohet ndjeshëm, nëse detyrimet e qeverisë nuk janë të tregtueshme. Praktikisht, në Shqipëri, bonot e thesarit të emetuara nga qeveria (Ministria e Financave), u kthyen shumë shpejt në një instrument jo të tregtueshëm. Nga ana tjetër, qeveria ka kërkuar që bankat të riinvestonin portofolin që maturohej. Kjo i ballafaqoi bankat me një investim jolikuid duke u vënë shpeshherë përballë mungesës së likuiditetit. Në këto kushte, për të shmangur shfaqjen e problemeve të likuiditetit në sistemin bankar, Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë duke ofruar REPO ose duke blerë letrat me vlerë nga portofoli i bankave të nivelit të dytë.

Rasti më ekstrem është ai i katër obligacioneve shtetërore të emtuara kundrejt detyrimeve të papaguara të kooperativave bujqësore. Këto obligacione, me urdhër administrativ u transferuan në një tjetër bankë shtetërore që kishte pozicion të favorshëm likuiditeti. Por, edhe kjo bankë, shumë shpejt u detyrua t'i nxjerrë këto obligacione në treg sekondar; të cilat, pas tentativave të pasuksesshme për t'i shitur, u blenë nga Banka e Shqipërisë.

Funksioni i këshilltarit.

Në disa vende, detyrë zyrtare e guvernatorit është edhe funksioni i këshilltarit ekonomik të qeverisë. Ky funksion e lejon atë që t'i drejtohet periodikisht parlamentit ose kabinetit për çështje të tilla si politikat në tregun e punës dhe ato fiskale. Në Shqipëri, Banka e Shqipërisë nuk merr pjesë aktive në hartimin apo në dhënien e këshillave për politikat jashtë fushës monetare e valutore. Megjithatë, një hap i bërë në këtë drejtim është pjesëmarrja e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë në Komitetin e Politikave Ekonomike që drejtohet nga Kryeministri.

Opozita e publikut ndaj inflacionit.

Një tjetër përcaktues i rëndësishëm i pavarësisë është mbështetja e publikut për objektivin e stabilitetit të çmimeve. Besohet se, nëse publiku është i prirur të kundërshtojë inflacionin, atëherë banka qendrore ka më tepër autoritet, vendimet e saj kanë më shumë shanse të kenë mbështetje të gjerë dhe për pasojë rritet shkalla e pavarësisë së saj. A ka në Shqipëri opozitë ndaj inflacionit të lartë? Jo, as në publikun e gjerë, as në rrethet financiare.

Por, sidomos negative në këtë drejtim është mendësia e popullsisë, e cila e drobitur ekonomikisht, ka humbur çdo lloj ndjenje "për sakrificimin e mirëqenies së saj" në këmbim të një zhvillimi ekonomik në të ardhmen. Mund të themi fare hapur se angazhimi i autoriteteve shqiptare në të shkuarën, por edhe sot, për të ruajtur ekuilibrat makroekonomikë dhe për të siguruar një normë të ulët inflacioni më shumë është arritur nën nevojën për të siguruar marrëveshje me institucionet ndërkombëtare, kryesisht FMN, dhe për të përfituar financimet e nevojshme prej tyre.

Personaliteti dhe reputacioni i drejtuesve të bankës qendrore dhe qeverisë.

Pavarësia reale e një banke qendrore është edhe produkt i politikës së përditshme, i ndërveprimeve institucionale dhe personale të drejtuesve të saj dhe të qeverisë, ose në kuadër më të ngushtë, të ministrisë së financave që ndikojnë në njërin ose në tjetrin drejtim. Tradita dhe personaliteti i guvernatorit mund të ndikojnë ndjeshëm në sjelljen e bankës qendrore.

Cilësia e departamentit të kërkimeve të bankës qendrore.

Cilësia e departamentit të kërkimeve të bankës qendrore i jep mundësi bankës që të krijojë qëndrimin e vet të pavarur në raport me institucionet e tjera ekonomike të kërkimit brenda sektorit publik dhe të rrisë peshën e saj në raport me qeverinë e sidomos me ministrinë e financave.

Pavarësisht sa më sipër, me të drejtë mund të lindë pyetja: a duhet që një bankë qendrore të fajësohet për çdo lëvizje të çmimeve të konsumit qoftë kjo edhe shumë e dukshme? A duhet të sqarojë Banka e Shqipërisë se përse çmimet e frutave dhe të perimeve në Shqipëri pësojnë luhatje të mëdha në stinë të ndryshme të vitit? A mund të konsiderohen rrjedhoja të politikës monetare efektet negative që gjenerojnë krizat e herëpashershme në rajon apo kriza energjitike etj..


Jo në asnjë mënyrë jo. Bankat qendrore përgjigjen dhe japin llogari për atë pjesë të inflacionit, i cili është derivat i një përbërësi të qëndrueshëm që është

gjithmonë i pranishëm, ecuria e të cilit në mënyrë të vazhdueshme udhëhiqet nga kërkesa. Ndërkohë, duhet të theksojmë që ekzistojnë kapërcime të përkohshme në çmimet relative, zhvillime këto që më së shumti ndodhin si pasojë e ndërveprimit të ofertës. Elementi i përhershëm, zakonisht quhet **inflacioni bazë** ose **inflacioni qendror**, dhe ai gjykohet të jetë një kontribut i drejtpërdrejtë i politikës monetare. Influenca e zhvillimeve në çmimet relative në përgjithësi, konsiderohet si “çrregullim” i përkohshëm, i cili nga këndvështrimi i politikës monetare duhet të injorohet si përsa i takon vendimmarjes, ashtu dhe analizës së vendimeve të marra në të shkuarën.

SHTOJCË 7. INFLACIONI BAZË DHE PËRAFRIME TË TJERA.

Në rastin e Shqipërisë, gjithnjë e më shumë po evidentohet domosdoshmëria e matjes dhe e përdorimit të këtij treguesi. Sikurse mund ta kenë konstatuar të gjithë të interesuarit, norma aktuale e inflacionit brenda saj është e ndikuar shumë nga faktorët sezonalë dhe për një kohë të gjatë ekonomia jonë gjendet nën efektin e faktorëve shock (kriza e Kosovës, kriza energjitike, kriza në Maqedoni etj.). Në qoftë se ju kujtohet grafiku numër 1 i paraqitur që në fillim, inflacioni në Shqipëri në njëfarë mase është produkt i ndryshimeve që pësojnë çmimet e nëngrupit ushqimor fruta dhe perime. Luhatshmëria në përgjithësi e çmimeve të grupit ushqimor si dhe faktorët shock të sipërpërmendur — këto të fundit duket se nuk po gjejnë derën nga dilet — janë të mjaftueshëm “për të maskuar” atë pjesë të inflacionit që shkaktohet nga rritja e ofertës së parasë. Për rrjedhim vështirësohet shumë dhe procesi i vlerësimit të efektivitetit të politikës monetare.

Figurë 6. Norma vjetore e inflacionit bazë.



Përpjekjet për ndërtimin e një përjasjeje të inflacionit bazë në Shqipëri kanë qenë të hershme – që nga viti 1995 – por gjatë gjithë periudhës seria e inflacionit bazë është përdorur vetëm për qëllime teknike dhe publikimi i saj ka qenë i kufizuar në ambiente specialistësh. Megjithatë, me kalimin e kohës dhe në përputhje me ambicjen e Bankës së Shqipërisë për të adoptuar një lloj politike monetare, në shënjestër të së cilës do të jetë vetë inflacioni, interesimi për këtë matje të re të inflacionit është rritur më tej dhe po punohet për të gjetur përjasjen më të mirë të mundshme të tij.

Duhet thënë se në praktikën e bankave qendrore ndërtohen disa matje të inflacionit bazë, nga të cilat përzgjidhet ai përafrim që përshkruan më mirë efektivitetin e politikës monetare. Përveç inflacionit bazë, në praktikën e saj të punës Banka e Shqipërisë llogarit dhe disa përafrime të tjera të ngjashme për nga natyra e tyre me konceptin e inflacionit bazë. Parimi kryesor edhe në këtë rast qëndron në shmangien e komponentëve të luhatshëm. Ndër këto përafrime mund të përmendim reduktimin e shportës me:

- i) nëngrupin ushqimor “fruta dhe perime”;*
- ii) disa nëngrupe ushqimore, të cilat gjykohen se preken ndjeshëm nga sezoni (nëngrupi “mish, pulë dhe peshk”, “bulmet dhe vezë”, “fruta dhe perime” dhe “vajra dhe yndyrna”);*
- iii) të gjithë grupin “ushqim, pije dhe duhan”.*

INFLACIONI: ÇFARË PASOJASH MBART AI?

Ekziston ideja e përgjithshme se kushdo është i aftë të shpjegojë se çfarë pësojnë xhepat tanë kur inflacioni fillon ngjitjen. Katastrofë e vërtetë. Ato pak para që me mundim vihen mënjanë fluturojnë për një ditë ose në raste të rralla nuk del dhe rroga e gjithë muajit për të blerë një bukë të vetme.

Dikush thotë se inflacioni nuk është gjë tjetër veçse tentativa e njerëzve për të

kursyer me qëllimin e vetëm për të blerë diçka, të cilën fatkeqësisht me kalimin e kohës nuk arrijnë ta blejnë kurrë.

Teoria makroekonomike servir një varg fatkeqësish të tjera, “autor” i të cilave është vetëm “zoti” inflacion.

Disa nga ato janë më të vështira për t’u asimiluar ndërkohë që ajo që thamë më sipër lehtësisht dhe realisht është kuptuar dhe do të vazhdojë të kuptohet edhe në të ardhmen.



35



Botuar nga : Banka e Shqipërisë, Sheshi “Skënderbej”, Nr.1, Tiranë.
Tel : 355-4-222230; 235568; 235569.
Faks : 355-4-223558.
e-mail: public@bankofalbania.org
[http:// www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi : 1000 kopje.